



Në bazë të dispozitave të nenit 8 të Ligjit të punës 03/L-212, Rregullores (QRK) Nr. 05/2022 për procedurat konkurruese dhe pranimi për nëpunësit administrativ dhe mbështetës, Statutit të Ndërmarrjes dhe rregulloreve të brendshme, Ndërmarrja Publike Lokale “Eko-Llapi” Sh.A. Podujevë shpallë këtë:

KONKURS

Për plotësimin e vendit të lirë të punës

1. **Titulli i Punës:** Mbikëqyrës/e i njësisë

I raporton: Kryeshefit/es Ekzekutiv/e

Nje (1) Pozitë: Mbikëqyrës/e i njësisë

Vendi i Punës: NPL “Eko-Llapi” Sh.A Podujevë

Orari i Punës: 40 orë në javë

Niveli i Pagës: 3

Periudha provuese: 6 muaj

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- a) Organizon dhe mbikëqyrë të gjitha operacionet e njësive të Ndërmarrjes.
- b) Harton elaboron, plane dhe programe lidhur me mirmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbëruara,
- c) Udhëheqë dhe disponon me evidencën e gjithëmbarshme të punëtorëve të njësive të Ndërmarrjes,

- d) Harmonizon dhe programon bilancet materiale dhe punuese për njësitë punuese më qellim të shtimit të efikasitetit në punë,
- e) Kontakton me kryepunëtorët dhe bënë mbikëqyrjen e punës së objekteve,
- f) Përcjell vazhdimisht të gjitha punët e njësive punuese,
- g) Kryen të gjitha punët tjera të cilat janë lëndë e afarizmit të njësive punuese,
- h) Rregullimi i orareve të punëtorëve,
- i) I/e orientuar drejt detajeve dhe në gjendje të mbaj nivel të lartë të përgjegjësisë,
- j) Sipas nevojës kryen dhe detyra të tjera të caktuara nga Kryeshefi,
- k) Është i obliguar të ketë sjellje korrekte duke respektuar kolegët,
- l) Mban regjistrin e mjeteve të punës dhe inventarit të Ndërmarrjes
- m) Ngarkon me mjete të punës punëtorët e Ndërmarrjes dhe është përgjegjës për Autoparkun e Ndërmarrjes,
- n) Detyra tjera relevante,
- o) I raporton Kryeshefi/es Ekzekutiv të NPL “Eko-Llapi”Sh.A Podujevë

Aftësitë:

- Të ketë aftësi të mira komunikimi, organizimi, kordinimi dhe menaxhimi,
- Shkathësi për të punuar në grup, nën presion dhe të dëshmoj fleksibilitet në punë;
- Aftësi për punë individuale dhe në ekip,
- Aftësi të mira analitike dhe logjike,
- Aftësi në zgjedhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve,
- Aftësi në delegim dhe menaxhim të kohës,
- Aftësi në intelegjencen emocionale,
- Shkathësi të mira në punën me kompjuter,
- Të jetë i/e gatshëm/e të punojë në të gjitha kushtet atmosferike dhe me orar fleksibil,
- Të ketë etikë dhe integritet në punë.

Dokumentet e kërkuara:

- Aplikacioni i NPL,
- Dëshmitë për shkollim - Shkolla e Mesme/Diplomë Universitare
- CV-në,
- Letër motivuese,
- Dëshmitë mbi kualifikimin profesional (diplomat e marrura jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara),
- Kopjen e letërnjoftimit
- Çertifikatën nga Giykata që nuk është nën hetime jo më e vjetër se (6) muaj
- Deklaratën nën betim(përpilohet nga kandidati)
- Patentë shofer kategoria B.
- Përvoja e punës së paku 1 vit detyra mbikëqyrës/e/menagjierial/e i/e dëshmuar me pasqyrën e Trusit Pensional

Procedura e Konkurimit

Kandidatët e interesuar, formularin zyrtar mund ta marrin në zyret e NPL **“Eko-Llapi” Sh.A. Rr. “Zahir Pajaziti” Podujevë (Ish Objekti i Komunës) Nr.19-Kati I**, çdo ditë pune nga ora 09:00-15:00. Kandidatët të cilët konkurojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues. Dokumentacioni dorëzohet në NPL **“Eko-Llapi” Sh.A Rr. “Zahir Pajaziti” Podujevë (Ish Objekti i Komunës) Nr.19-Kati I**,

Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen në procedura të tjera të rekrutimit.

Për kohën dhe vendin e mbajtjes së intervistave kandidatët do të njoftohen përmes njoftimeve të cilat do të publikohen në web faqen e Komunës së Podujevës dhe në tabelën e shpalljeve në (objektin e ish Komunës), pas mbylljes së konkursit

Sqarim:

Fillimi i punës për pozitën e cekur më lartë, nuk do të jetë domosdoshmëri pas përfundimit të procedurave të rekrutimit të këtij konkursi por në vartësi të nevojave të Ndërmarrjes.

Aplikacionet dhe dokumentacioni i pakompletuar sipas kërkesave të përcaktuara në këtë shpallje si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit, nuk do të shqyrtohen.

Kandidati/ja i/e përzgjedhur obligohet që para nënshkrimit të kontratës të sjellë çertifikatën mjekësore që është në gjendje të mirë shëndetësore si fizike ashtu dhe psikike.

Shpallja është e hapur që nga data 03.07.2024 deri më 17.07.2024

NPL "Eko-Llapi" Sh.A. Podujevë

Kryeshafi Ekzekutiv

